

ALBIZ – Reformë e arsimit të mesëm ekonomik në Shqipëri

Numri i projektit

OZA 8247-00/2009

Kohëzgjatja

nëntor 2009 – nëntor 2013

Buxheti në total

828.565 euro

Kontributi në formë granti nga ADC

800.000 euro

Donatorë të tjerë

KulturKontakt Austria
Ministria Federale Austriake e Arsimit,
Artit dhe Kulturës

Agjencia zbatuese

KulturKontakt Austria

Vendi

Shkollat e mesme ekonomike në:
Berat, Elbasan, Korçë, Lezhë,
Lushnjë, Peshkopi, Pogradec,
Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë

Partnerë dhe përfitues të projektit

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe
Formimit Profesional dhe
Kualifikimeve

Kontakt

Ms. Sabine Schubert
k-education project office Tirana
Rruga „Naim Frasheri“ 37/(kati IV)
Tirana
Tel/Fax +355 (0)4 2227912
E-Mail:
sabine.schubert@kulturkontakt.or.at
Web:
www.k-education.at
www.al-biz.al

KONTEKSTI

Sektori i arsimit ka vuajtur dukshëm tranzicionin dhe pasojat e tij. Vitet 1990 u karakterizuan nga mbyllja e shumë shkollave profesionale në të gjithë vendin dhe numri i tyre ra nga 308 në vitin 1990 në 41 të tilla në vitin 2006, duke krijuar një hendek të thellë në ofertën e arsimit profesional dhe duke mos i ofruar tregut të punës fuqi punonjëse të kualifikuar.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka hartuar një Strategji Kombëtare të Arsimit 2004-2015, duke i dhënë, kështu, një vend më të rëndësishëm arsimit të mesëm profesional. Synimi i saj është që në katër vitet e ardhshme të rrisë pjesëmarrjen në arsimin profesional nga 17% në 40% në raport me arsimin e mesëm në tërësi. Po ashtu, në vitin 2006 u krijua Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional.

Qysh prej vitit 1995 Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim ka mbështetur arsimin profesional në Shqipëri nëpërmjet projekteve të ndryshme, si ngritja e shkollave të para të hoteleri-turizmit, mbështetjes së shkollave ekonomike dhe të agro-biznesit dhe prej vitit 2009, kjo mbështetje vijon me projektin ALBIZ.



Ceremonia e çeljes së projektit ALBIZ

ALBIZ mbështet shkollat e mesme ekonomike shqiptare për të qenë më atraktive, të rrisin cilësinë dhe të forcojnë lidhjet me tregun e punës. Projekti zbatohet nga KulturKontakt Austria në bashkëpunim me Ministrinë Shqiptare të Arsimit dhe Shkencës dhe kontribuon në arritjen e synimit të vendosur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

OBJEKTIVA

- Trajnimi i mësuesve dhe trajnimi i trajnerëve
- Zhvillimi dhe sigurimi i cilësisë në të gjitha shkollat e mesme ekonomike shqiptare
- Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit i shkollave të mesme ekonomike me biznesin dhe përmirësimi i ofertës së vendeve të praktikës nëpërmjet PASO-ve (koordinator i shkollës për marrëdhëniet me partnerët socialë)
- Hartimi i kurrikulave shkollorë në përputhje me skelet-kurrikulën e re të arsimit profesional
- Zhvillimi dhe menaxhimi i shkollës
- Krijimi i firmave ushtrimore në shkollat ekonomike, në të cilat nuk ka të tilla
- Zbatimi i parimeve integritit gjinor në shkollat e mesme ekonomike

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i arsimit ekonomik në Shqipëri nëpërmjet përshtatjes së kualifikimeve të nxënësve që përfundojnë arsimin profesional me kërkesat e tregut të punës dhe tendencat ndërkombëtare të zhvillimit ekonomik. Një aspekt i rëndësishëm është **forcimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe mjedisit**. Kjo po arrihet nëpërmjet një komunikimi dhe bashkëpunimi më të mirë e më intensiv me përfaqësues të sektorit të biznesit.



AKTIVITETE

Seminaret zhvillohen për hartimin e materialeve të reja mësimore, metodat moderne të mësimdhënies, sigurimin e cilësisë, bashkëpunimin me biznesin lokal dhe partnerë të tjerë.

Ditët e Dyerve të Hapura organizohen nga çdo shkollë dhe synojnë të eliminojnë hendekun ndërmjet shkollës dhe biznesit dhe të krijojnë raporte (marrëdhënie) të fuqishme e të qëndrueshme.



Seminar i zhvilluar në Vlorë

Infrastrukturë: pajisje të reja për zyrën e firmës ushtrimore në 12 shkollat e përfshira në projekt.

Vizita studimore në shkolla profesionale ekonomike në Austri me fokus në menaxhimin e cilësisë dhe në metodat moderne të mësimdhënies.

